



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 114 Akti

Nr. 173 Vendimi
Tiranë, më 1.7.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Genta Tafa (Bungo)	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 27 qershor 2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Artan Madani, me funksion prokuror/drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;**
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit** është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në pikën 5, të nenit 3, dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, me funksionin prokuror/drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenin 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin në datën 15.3.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Etleda Çiftja dhe Pamela Qirko. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 26.3.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ duke u bazuar në të tria kriteret¹ e rivlerësimit.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, vlerësimi i pasurisë, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, kontrolli i figurës, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e

¹ Vlerësimi të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, vlerësimi i aftësive profesionale, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 19.1.2018, e **Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave**, me anë të së cilës dërgohet një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin fillestar për subjektin e rivlerësimit me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 17.10.2018), në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar ***përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani.***

12. **Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 18.10.2018, për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 5.6.2019, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kritere për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, në datën 7.6.2019, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 10.6.2019 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 22.6.2019.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë me anë të postës elektronike, në datën 24.6.2019.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 27.6.2019, ora 10:00, në ambientet e Pallatit e Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, kërkoi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Artan Madani ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka sjellë prova dhe shpjegime, kur janë kërkuar. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2 Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

21.3 Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4 Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017² dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga

² “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga Prokuroria e Përgjithshme; (f) relacionin mbi gjetjet e depozituar nga Vëzhguesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit në datën 12 prill 2019, (g) denoncimet e publikut; (e) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

23.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani.

23.2 Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

23.3 Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2) të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

- i. 50 % të pasurive të llojit, apartament banimi me sip. 146.46 m² dhe garazh me sip. 10.5 m², të ndodhura në Durrës, me vlerë totale 5,500,000 lekë;
- ii. 50 % të pasurive të llojit likuiditete, (1) vlera 5,500,000 lekë depozituar në fond investimi në “Raiffeisen Bank”, dhe (2) vlera 1,200,000 lekë gjendje *cash* në banesë.

24. **Apartament banimi**, me sip. 146.46 m² dhe **garazh** me sip. 10.5 m², të ndodhur në lagjen nr. ***, Rr. “***”, pallati “***”, Durrës.

- i. vlera e deklaruar: 5,500,000 lekë;
- ii. pjesa takuese: 50 % në bashkëpronësi me bashkëshorten;
- iii. burimi i krijimit: nga kursimet ndër vite të të ardhurave dhe pjesëtim vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000.

24.1 Sipas vetëdeklarimit të bërë nga subjekti, vlera totale e pasurive të mësipërme, sipas aktit të porosisë të bërë në vitin 2001, është 5,500,000 lekë, ndërsa për arsye të mospërfundimit të banesës, në aktet e shitblerjes vlera e apartamentit (karabina) është 1,700,000 lekë dhe vlera e garazhit është 250,000 lekë, shpenzime të cilat janë kryer më pas për punimet.

24.2 Mënyra e fitimit të këtyre pasurive: Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI rezulton se, pasuritë apartament dhe garazh janë përfituar nëpërmjet dy kontratave noteriale³ të datës 1.10.2004.

24.3 Deklarimi i kësaj pasurie ndër vite: Në deklarinimin fillestar të pasurisë dhe interesave dorëzuar më 24.3.2004, subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi 3+1, me vlerë 5.5 milionë lekë. Si burim krijimi është deklaruar: (1) nga pjesëtimi vullnetar i një banese në bashkëpronësi; dhe (2) kursimet e tij. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 (në vijim DPV) si edhe DPV-të vjetore të viteve në vijim dorëzuar në ILDKPKI, subjekti nuk ka deklaruar të dhëna të tjera lidhur me këto pasuri.

24.4 Hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit lidhur me këtë pasuri

ZVRPP-ja Durrës⁴ informon se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka të regjistruar në pronësi të tij apartamentin në z.k. ***, vol. ***, f. ***, si dhe garazhin në z.k. ***, vol. ***, f. ***. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Durrës konfirmohet se këto pasuri janë: (1) apartament banimi me sip. 146.46 m²; dhe (2) garazh me sip. 10.5 m², të blera nga shoqëria “****” sh.p.k., nëpërmjet kontratave noteriale të shitblerjes të datës 1.10.2004. Rezulton se këto dy pasuri janë regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 24.11.2004.

24.5 Nisur nga të dhënat e mësipërme, Komisioni vëren se subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktë të dhënat lidhur me këto pasuri dhe gjendjen e tyre në momentin e deklarimit, por duket se ka mospërputhje në deklarinimet e subjektit me provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me vlerën e deklaruar të këtyre pasurive. Gjithashtu, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën fillestare të pasurisë dhe as në DPV-në e vitit 2004 pasurinë e llojit garazh të regjistruar në emrin e tij në vitin 2004.

24.6 Në përgjigje të pyetësorëve, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se nuk është kryer ndonjë aktporosie apo kontratë sipërmarrjeje në vitin 2001 për këto pasuri, por ka pasur vetëm marrëveshje verbale midis tij dhe shoqërisë ndërtuese. Ai ka shpjeguar se në vitin 2001 apartamenti ka qenë në fazën e karabinasë dhe palët kanë rënë dakord që punimet e tjera që do të nevojiteshin për përfundimin e këtij apartamenti do të bëheshin nga blerësi me koston e tij.

24.7 I pyetur nga Komisioni gjatë hetimit në lidhje me shpenzimet, subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumentacion provues për sa i përket punimeve të kryera në apartament, për shkak të periudhës së gjatë kohore, pothuajse 20 vjet, si dhe informalitetit të viteve 2000.

24.8 Shoqëria “****” sh.p.k.⁵, ka informuar se marrëveshja verbale për këto pasuri është kryer në fund të vitit 2001, kur klienti (i referohet subjektit të rivlerësimit) mori përsipër përfundimin e të gjitha punimeve të brendshme të apartamentit.

24.9 Nga hetimi, bazuar në informacionin e përcjellë nga ZVRPP-ja Durrës⁶, ka rezultuar se pallati ku ndodhet ky apartament ka marrë lejen për (shfrytëzim) banimi nga Seksioni i

³ Kontratave noteriale me nr. ***, dhe nr. ***, të datës 1.10.2004.

⁴ Me shkresat nr. *** prot., dhe nr. *** prot., datë 3.5.2018.

⁵ Vërtetimi i datës 8.10.2018, lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k., bashkëlidhur pyetësorit nr. 2.

⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 5.11.2018.

Urbanistikës së Këshillit të Rrethit Durrës më 20.9.2000, dhe kolaudimin nga kolaudatori i licencuar në datën 30.9.2000.

24.10 Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, të dërguar në datën 21.11.2018, ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se pagesa për shoqërinë “****” sh.p.k., për blerjen e apartamentit + garazh në qytetin e Durrësit, është bërë në dy këste. Konkretisht, kësti parë është paguar menjëherë pas marrëveshjes verbale në fund të vitit 2001 (periudha nëntor - dhjetor), në vlerën 1,000,000 lekë dhe kësti i dytë në shumën prej 950,000 lekësh, është paguar në fund të vitit 2002 (nëntor - dhjetor 2002).

24.11 Siç e evidentua edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të pasurive apartament banimi + garazh: (1) kursimet ndër vite; dhe (2) të ardhurat e përfituara nga pjesëtimi vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000.

24.12 Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI, si dhe në dokumentacionin e ardhur nga ZVRPP-ja Durrës⁷, rezulton se në datën 22.12.2000 babai i subjektit, z. S.M., ka shitur një apartament për vlerën 1.9 milion lekë.

24.13 Referuar përgjigjeve të pyetësorëve, subjekti ka deklaruar se babai tij i ka dhuruar shumën prej 1,500,000 lekësh. Lidhur me këtë fakt, ka dorëzuar si dokument provues deklaratën noteriale⁸ të datës 8.10.2018.

24.14 Komisioni vëren se subjekti nuk disponon aktdhurimi të përpiluar në kohën kur ka ndodhur dhurimi dhe se nuk e ka deklaruar si dhurim shumën prej 1.5 milion lekësh në asnjë nga deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën “Vetting”, por e ka konsideruar si pjesëtim vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000.

24.15 Në përgjigjet e dorëzuara në Komision, ndër të tjera, subjekti ka shpjeguar se shuma prej 3,550,000 lekësh (5,500,000 lekë - 1,950,000 lekë), është shpenzuar për përfundimin e banesës në periudhën 2001 – 2003.

24.16 Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se të afërmit e bashkëshortes së tij i kanë ndihmuar herë pas here me shuma parash, të cilat, sipas tij, kanë shërbyer në rritjen e kursimeve ndër vite. Shumat e mjeteve monetare të pretenduara si ndihmesë financiare nga të afërmit e bashkëshortes paraqiten si më poshtë:

- i. 350,000 lekë të disponuara nga bashkëshortja e subjektit (Xh.M.) Madani në momentin e martesës si nga kursimet e saj ndër vite dhe dhuratë nga familja për martesë (pajë);
- ii. vlera prej 1,000,000 lekësh, dhënë nga babai i bashkëshortes për vitet 1997 – 1999 (me rastin e lindjes së dy djemve nga 200,000 lekë; në vitin 1999, shumën 250,000 lekë dhe në vitin 2000, shumën prej 350,000 lekësh);
- iii. 300,000 lekë në formë kryerje punimesh në vitin 2001, nga vëllai i bashkëshortes.

24.17 Komisioni kreu analizën e tregueseve financiarë lidhur me mundësinë e kryerjes së pagesës dhe shpenzimeve në shumën prej 5,500,000 lekësh nga subjekti i rivlerësimit për prenotimin dhe kryerjen e punimeve për apartamentin dhe garazhin, deri në fund të vitit 2003.

⁷ Me shkresat nr. **** prot., dhe nr. ****prot., datë 3.5.2018.

⁸ Nr. ***.

24.18 Theksojmë këtu se, analiza financiare për periudhën 1999 – 2003 është bërë duke marrë për bazë vlerën e vetëdeklaruar nga subjekti për pasuritë në pronësi të tij, apartamentin dhe garazhin, duke mos u bazuar në vlerën e evidentuar në kontratat e shitblerjes së këtyre pasurive. Por, paraprakisht nuk u morën në konsideratë deklaramet e tij lidhur me dhurimet e përfituara nga familjarët e bashkëshortes, duke i kërkuar shpjegime me rezultatet e hetimit.

24.19 Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e barra e provës për të provuar aftësinë financiare të personave të tjerë të lidhur, si dhe burimin e ligjshëm të shumave të dhuruara, shuma të cilat kanë shërbyer për të rritur kursimet familjare të subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij. Konkretisht, subjektit iu kërkua të provonte aftësinë financiare të babait të tij për shumën prej 1,500,000 lekësh, të deklaruar si burim i krijimit të këtyre pasurive, si dhe të dokumentonte ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të babait të bashkëshortes së tij për shumën prej 1,000,000 lekësh, të pretenduar si ndihmesë financiare nga ana e tij. Gjithashtu, lidhur me këto pasuri subjektit iu kërkua të shpjegojë pasaktësitë lidhur me mosdeklarimin e garazhit në deklaratën fillestare të deklaramet të pasurisë, apo në DPV-në e vitit 2004, si dhe faktit se nuk është deklaruar si burim krijimi i pasurisë apartament, shuma prej 300,000 lekësh, në formë kryerje punimesh nga vëllai i bashkëshortes së tij.

24.20 Në prapësimet⁹ e sjella pranë Komisionit subjekti, fillimisht, ka shpjeguar se pallati ku ndodhet apartamenti i tij ka qenë një ndër pallatet e para të ndërtuara në qytetin e Durrësit, në ndërtimin e të cilit ka pasur një mori problemesh në lidhje me afatin e përfundimit të punimeve në tërësi, por edhe të formalizimit të kontratave të banorëve. Ky fakt rezulton i provuar si nga gjykimi civil i firmës së ndërtimit për detyrimin e ZVRPP-së Durrës për regjistrimin e pallatit, edhe nga fakti i përmendur më sipër se marrja e lejes së shfrytëzimit (datë 20.9.2000) është përpara kolaudimit të objektit (sipas procesverbalit të datës 30.9.2000). Për shkak të formalizimit me probleme të këtij objekti, kontratat e shitblerjeve janë lidhur prej fundvitit 2004 e në vijim.

24.21 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se kontrata e energjisë elektrike për këtë apartament, në emër të subjektit të rivlerësimit, është lidhur me operatorin e OSHEE-së në datën 21.1.2004, çka konfirmon faktin se subjekti, paraprakisht, ka prenotuar dhe banuar në këtë apartament dhe më pas është formalizuar shitblerja e kësaj pasurie.

24.22 Sikurse e ka sqaruar në përgjigjet e pyetësorëve të depozituara në Komision¹⁰, subjekti ka provuar se edhe banorëve të tjerë të këtij pallati u janë formalizuar kontratat e shitblerjeve në fund të vitit 2004 dhe në vitin 2005, duke pretenduar se ata kishin filluar të jetonin në këto banesa shumë kohë para tij. Subjekti ka depozituar si prova kopje të kontratave të shitblerjes të lidhura mes shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k., dhe banorëve të tjerë të pallatit, ku ndodhet edhe apartamenti i tij.

24.23 Nga verifikimi i këtyre kontratave konstatohet se ato kanë vlera të përafërta të shitjes së pasurive apartament apo apartament + garazh, të gjitha nën 2 milionë lekë.

⁹ Sqarimet e dërguara me *e-mail*-in e datës 22.6.2019.

¹⁰ Me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, datë 10.10.2018.

24.24 Siç është evidentuar edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se vlera totale e paguar dhe e shpenzuar prej tij për apartamentin dhe garazhin, deri në momentin para se të hynte në banesë, është në total 5,500,000 lekë. Subjekti ka pretenduar se, meqenëse apartamenti u mor në dorëzim prej tij në gjendje karabina, shoqërisë ndërtuese i ka paguar në total vlerat sipas përcaktimit në kontratat e datës 1.10.2004, ndërsa diferencën prej 3,550,000 lekësh e ka investuar vetë në apartament duke kryer punimet e nevojshme për përfundimin e tij. Lidhur me punimet e kryera subjekti deklaroi se ato janë kryer nga grupe të vogla pune dhe bazuar në marrëdhënie verbale. Edhe materialet e ndërtimit për shkak të informalitetit të kohës nuk janë blerë të shoqëruara me faturat përkatëse.

24.25 Referuar të dhënave të Entit Kombëtar të Banesave, bazuar në Udhëzimet e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kosto mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit”, rezulton se për periudhën 2001 – 2003 kostoja mesatare për ndërtimin e sipërfaqes së shfrytëzueshme në qytetin e Durrësit ka qenë 29,967.33 lekë/m² (27,810+30,551+31,541)/3, pasqyruar kostot mesatare sipas viteve përkatëse në tabelën si më poshtë:

Periudha	Kosto mesatare ndërtimi për sipërfaqe shfrytëzimi/ në lekë	Baza ligjore
Viti 2001	27,810	udhëzim nr. 5, datë 31.5.2001, i K. M
Viti 2002	30,551	udhëzim nr. 3, datë 16.10.2002, i K. M
Viti 2003	31,541	udhëzim nr. 1, datë 8.5.2003, i K. M

24.26 Bazuar në të dhënat e mësipërme, kostoja mesatare e ndërtimit për apartamentin me sipërfaqe shfrytëzimi 146.46 m², është në vlerën 4,389,015 lekë. Gjithashtu, neni 851 i Kodit Civil parashikon se çmimi i sipërmarrjes llogaritet në bazë të tarifave ekzistuese, atëherë kur palët nuk e kanë caktuar çmimin e sipërmarrjes. Por, ky nuk është rasti, përderisa palët kanë përcaktuar saktësisht vlerën e pasurisë së paluajtshme, objekt i kontratës së sipërmarrjes.

24.27 Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e punimeve për apartamentin është kryer nga shoqëria ndërtuese, Komisioni i vlerëson bindëse deklaratimet e subjektit lidhur me vlerën e këtyre pasurive, apartamentit dhe garazhit. Pra, subjekti, në deklaratën fillestare të pasurisë, ka deklaruar vlerën reale të pasurive që kishte në përdorim, edhe pse nuk dispononte dokument për posedimin e tyre. Duke qenë se në këtë periudhë nuk ekzistonte detyrimi për deklarimin e pasurive, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi subjekti për mungesën e disponimit të faturave për shpenzimet e kryera.

24.28 Komisioni vëren se subjekti, fillimisht, ka pasur vetëm një marrëveshje verbale me shoqërinë ndërtuese, kjo për shkak të mirëbesimit që ekzistonte mes palëve¹¹, por gjithsesi, e ka deklaruar këtë marrëdhënie në deklaratën fillestare të pasurisë të dorëzuar në ILDKPKI, duke pasqyruar me vërtetësi pasurinë apartament në përdorim nga ana e tij dhe vlerën reale të paguar për blerjen e saj, si dhe shpenzimin real për përfundimin e kësaj banese. I njëjti deklaram është bërë nga subjekti edhe në deklaratën “Vetting”. Pra, duket se subjekti ka qenë i sinqertë

¹¹ Sipas vetëdeklarimit të subjektit.

në deklarin, duke deklaruar vlerën reale të pronës së tij. Komisioni, në analizë të plotë të provave dhe fakteve, konstaton se subjekti ka qenë i vërtetë dhe i plotë në deklarin e tij.

24.29 Lidhur me mosdeklarin e pasurisë garazh në deklarin fillestare të pasurisë (viti 2003), në prapësimet e tij, subjekti i qëndron shpjegimeve të dhëna¹² më parë në Komision, duke sqaruar se apartamentin dhe garazhin i ka konsideruar si një pasuri të vetme dhe se vlera prej 5,500,000 lekësh përfaqëson vlerën e apartamentit dhe garazhit. Në lidhje me këtë paqartësi, subjekti ka dhënë shpjegimet e tij edhe në ILDKPKI, me procesverbalin e mbajtur në datën 14.1.2016.

24.30 Komisioni vlerëson se situata lidhur me pasurinë garazh dhe mosdeklarin e saj në deklarin fillestare të pasurisë të vitit 2003 apo të DPV-së së vitit 2004 (pasi ishte formalizuar blerja në tetor të vitit 2004), mund të konsiderohet si pasaktësi nga subjekti, në konsideratë të faktit se në deklarin fillestare të pasurisë ai ka deklaruar pasurinë apartament dhe vlerën reale të saj duke menduar se në këtë pasuri përfshihej edhe garazhi, pavarësisht faktit që nuk kishte formalizuar blerjen e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit e ka sqaruar këtë pasaktësi në deklarin “Vetting” dhe konstatohet se ky deklarin ka qenë i saktë.

24.31 Pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar prenotimin e këtij garazhi nëpërmjet marrëveshjes verbale në deklarin fillestare të pasurisë, Komisioni arsyeton se pika 2, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzojë/plotësojë një deklarin të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor prej ku fillojnë të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht deklarata “Vetting” dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me deklarin e re të pasurisë (“Vetting”), dhe jo me deklarinet e mëparshme të tij. Këto deklarime mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Këto pasaktësi, në deklarin për herë të parë, nuk mund të shërbejnë si provë për të vërtetuar ndonjë qëllim të mundshëm për fshehje pasurie, për aq kohë sa është deklaruar saktë në deklarin “Vetting”.

24.32 Lidhur me vlerën prej 1,500,000 lekësh, të deklaruar si burim krijimi i këtyre pasurive, subjekti ka sqaruar se meqenëse babai i tij i dha shumën prej 1,500,000 lekësh, e cila përfaqëson të ardhurat e familjes së tij të krijuara nga shitja e apartamentit dhe të ardhura të tjera që dispononin, e ka vlerësuar ta pasqyrojë si aktpjesëtimi vullnetar të pasurisë këtë ndihmesë në vlera monetare që i ka dhënë familja e tij. Subjekti ka paraqitur si provë deklarin noteriale¹³ të datës 8.10.2018, sipas së cilës babai i tij, z. S.M., deklaroi se mbi bazën e traditës familjare, me pëlqim të bashkëfamiljarëve, ka mundësuar dhënien e vlerës prej 1,500,000 lekësh djalit të tij, z. Artan Madani, pasi po kryente punimet për përfundimin e banesës së tij.

24.33 Komisioni vëren se, në deklarin fillestare të pasurisë dhe në deklarin “Vetting”, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë apartament dhe garazh, të ardhurat e përfituara prej pjesëtimit vullnetar nga shitja e banesës së prindërve në vitin 2000. Pavarësisht se nuk ka një akt pjesëtimi vullnetar të kësaj pasurie, Komisioni çmon se, subjekti, pavarësisht formës, ka deklaruar se këto janë të ardhura të përfituara prej tij dhe që kanë shërbyer për

¹² Me pyetësorin e datës 10.10.2018.

¹³ Me nr. ***.

blerjen/kryerjen e shpenzimeve për pasuritë e mësipërme. Moscilësimi apo mosdeklarimi i tyre si dhuratë/ndihmesë financiare në deklaratat e pasurisë të dorëzuara në ILDKPKI, nuk mund të konsiderohen pasaktësi, duke shtuar këtu faktin se këto të ardhura janë marrë nga subjekti në vitin 2001, pra kur nuk kishte asnjë bazë ligjore për deklarin e pasurisë. Në këtë vlerësim, Komisioni mban parasysh edhe marrëdhënien familjare të ngushtë ndërmjet subjektit dhe babait të tij. Komisioni çmon se rëndësi ka evidentimi i mundësisë financiare që ka pasur babai i subjektit për dhurimin e kësaj shume.

24.34 Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerëson se referuar pikës 14, të nenit 3, si dhe pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, z. S.M., (babai i subjektit) bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

24.35 Rezulton se, provuar se në datën 22.12.2000 babai i subjektit të rivlerësimit, z. S.M., ka shitur¹⁴ pasurinë e llojit shtëpi banimi të ndodhur në Durrës, për vlerën prej 1,900,000 lekësh. Pra, Komisioni vlerëson se në vitin 2001 babai i subjektit ka pasur burime financiare të ligjshme për dhurimin e shumës prej 1,500,000 lekësh.

24.36 Komisioni, me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm, kreu verifikime lidhur me të ardhurat dhe pasuritë e babait të subjektit të rivlerësimit, z. S.M.

24.37 ZVRPP-ja Durrës informon se z. S.M., ka në pronësi (pasuri aktive) një godinë me nr. pasurie ***, ndodhur në z.k. nr. ***, vol. ***, f. ***. Rezulton se kjo pasuri (godinë 4-katëshe, me sip. ndërtimi 91 m² dhe truall me sip. 205 m²) është blerë¹⁵ në datën 15.3.2002 nga vjehri i tij, z. M.M., në vlerën prej 1,000,000 lekësh. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me vlerën e blerjes së kësaj pasurie, si dhe i kërkoi të provojë aftësinë financiare të babait të tij për blerjen e kësaj pasurie.

24.38 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në këtë godinë ka jetuar së bashku me familjen e tij pa qira, për rreth 2 vjet, që nga momenti i shitjes së banesës së tyre. Në momentin e blerjes (viti 2002) kjo banesë rezultonte me dokumentacion të rregullt dhe kishte leje ndërtimi që nga viti 1996, por ishte e papërfunduar plotësisht (vetëm kati i tretë dhe një pjesë e katit të katërt e përfunduar, pjesa tjetër karabina), e ndërtuar me materiale të cilësisë dhe standardit të ulët dhe se ndodhej në një zonë informale dhe të paurbanizuar, në zonën e Kënetës, Durrës. Kjo godinë është ndërtuar në truallin, të cilin babai i bashkëshortes së subjektit e ka fituar me vendimin e KKKP-së Durrës, si trashëgimi. Në këto rrethana që gjendej kjo godinë, si dhe në konsideratë të faktit se ekzistonte një marrëdhënie e posaçme mes shitësit dhe blerësit, subjekti argumenton se është i vërtetë çmimi i vendosur dhe i paguar nga familja e tij për blerjen e kësaj pasurie.

24.39 Lidhur me mundësinë financiare të babait të tij, për pagesën e shumës prej 1,000,000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar se babai dhe nëna e tij, për shkak të daljes në pension në moshë të re (52 dhe 53 vjeç), kanë krijuar të ardhura dhe konkretisht, babai duke punuar në këmbim valutor, shitje librash etj., ndërsa nëna ka punuar si mësuese në kurse private dhe se në vitin 1996 ka përfituar të ardhura si trashëgimtare nga shitja e një sipërfaqe toke të kthyer nga KPPP-ja në Shijak, në vlerën 500,000 lekë. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar

¹⁴ Kontrata nr. ***, datë 22.12.2000.

¹⁵ Kontratë shitjeje nr. ***.

se në vitin 1996 prindërit e tij, një pjesë të kursimeve që kishin, shumën prej 500,000 lekësh, i kanë depozituar në firmën piramidale “****” dhe më pas i kanë tërhequr duke përfituar interesin prej 270,000 lekësh. Si të ardhura të tjera të disponueshme për blerjen e kësaj pasurie janë deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në vitin 2000, pjesa e mbetur prej 400,000 lekësh.

24.40 Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision provat shkresore si më poshtë:

- i. vërtetim pronësie i datës 12.2.1999, lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës;
- ii. vendimin nr. ***, datë 7.6.2007, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;
- iii. deklaratë noteriale¹⁶ e datës 17.6.2019, e shtetases F.Sh.;
- iv. kontratë huaje nr. *** regj., datë 16.3.1996, përpiluar nga avokati Xh. H.

24.41 Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me vlerën e blerjes së pasurisë nga babai i tij duken bindëse, si dhe provohet mundësia financiare që ai kishte për të paguar çmimin prej 1,000,000 lekësh për blerjen e saj. Nisur nga ky përfundim, Komisioni përforcon bindjen, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se babai i subjektit në fillim të viteve 2000 ka pasur mundësi financiare për t’i dhënë/dhuruar shumën prej 1,500,000 lekësh subjektit të rivlerësimit.

24.42 Lidhur me aftësinë financiare të babait të bashkëshortes së tij, për t’i dhuruar shumën prej 1,000,000 lekësh, në prapësimet e tij, subjekti ka shpjeguar se babai i bashkëshortes ka krijuar të ardhura nga puna e tij në vazhdimësi si kapiten dhe kryemekanik pranë subjekteve të ndryshme të portit të Durrësit, por edhe nga pasuria e kthyer nga KKKP-ja Durrës në vitin 1996. Nga shitja e një pjese të këtyre pasurive (parcela të ndryshme) ka përfituar të ardhura që justifikojnë shumën prej 1,000,000 lekësh të dhuruara për vitet 1997 – 1999 (për lindjen e fëmijëve dhe dhurime të tjera). Gjithashtu, subjekti pretendon se bashkëshortja e tij ka përfituar një shumë prej 350,000 lekësh, e cila ka qenë pjesë e të ardhurave të saj në momentin që ka lidhur martesë. Kjo vlerë është krijuar nga puna e saj, por edhe nga të ardhurat e dhuruara/të dhëna si ndihmë financiare nga familjarët e saj.

24.43 Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision provat shkresore:

- i. kontratë shitje me nr. ***, datë 1.8.1996, vlera e përfituar 600,000 lekë;
- ii. kontratë shitje me nr. ***, datë 30.8.1996, vlera përfituar 2,340,000 lekë;
- iii. kontratë shitje me nr. ***, datë 12.12.2001, vlera përfituar 300,000 lekë.

24.44 Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe zakonet e traditat e vendit, Komisioni konstaton se, babai i bashkëshortes së subjektit ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhurimet/ndihmën financiare në favor të subjektit dhe bashkëshortes së tij (vajzës së tij).

¹⁶ Deklarata noteriale me nr. ***, datë 17.6.2019.

24.45 Lidhur me faktin se pse nuk është deklaruar si burim krijimi i pasurive apartament + garazh, shuma prej 300,000 lekësh në formë punimesh nga vëllai i bashkëshortes, subjekti ka shpjeguar se, referuar ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, nuk parashikohej një zë i veçantë për sa i përket dhurimeve në natyrë, kjo sipas parashikimeve të nenit 4, të këtij ligji. Subjekti ka shpjeguar se shumën prej 1,000,000 lekësh, të dhënë nga babai i bashkëshortes dhe shumën 300,000 lekë në formë punimesh nga vëllai i bashkëshortes, i ka konsideruar si të ardhura të kursyera, të cilat janë përfshirë në shpenzimet për blerjen e apartamentit dhe garazhit.

24.46 Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision edhe provat shkresore si: (i) dy deklarata noteriale¹⁷ të datës 15.6.2019, nëpërmjet të cilave babai dhe vëllai i bashkëshortes së tij konfirmojnë deklaratimet e subjektit; si dhe (ii) dokumentet, dy vërtetime të vitit 1998, sipas të cilave vërtetohet se shtetasi A.M., vëllai i bashkëshortes, ka depozituar kërkesë për lëshim të “kartës provizore të lejes së qëndrimit të huajit” dhe për lëshimin e “lejes së qëndrimit për rezidencë, për emigrantë”, në shtetin grek. Sipas këtyre dy dokumenteve provohet se ky shtetas ka qenë në marrëdhënie pune në atë kohë, pasi ka dorëzuar si dokumentacion librezën e sigurimeve dhe kopje të kontratës së punësimit, duke provuar kështu aftësinë paguese për shumën 300,000 lekë, të dhënë si ndihmë financiare për subjektin e rivlerësimit.

24.47 Lidhur me konstatimin se këto të ardhura të dhuruara/të dhëna si ndihmë financiare nuk janë specifikuar si burim krijimi i pasurisë apartament + garazh, Komisioni vëren se subjekti ka pasur koncept të gabuar të deklaratimit të burimit të krijimit të pasurisë. Duket se subjekti, në deklaratën fillestare të deklaratimit të pasurisë dhe në deklaratën “Vetting”, këto të ardhura i ka përfshirë *te kursimet e tij në vite*, në konsideratë edhe të faktit se për kohën kur ato janë përfituar ai nuk ka pasur detyrimin për deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë. Gjithsesi, Komisioni vlerëson se, në kuptim të nenit 30¹⁸, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kjo pasaktësi nuk mund të sjellë pasojë në këtë proces, pasi nuk cenon ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie.

24.48 Në prapësimet e tij subjekti kërkoi llogaritjen e disa të ardhurave shtesë të cilat nuk ishin përfshirë në analizën financiare, duke paraqitur si dokumentacion provues: (i) vërtetimin me nr. *** prot., datë 11.6.2019, nga Prokuroria e Përgjithshme; dhe (ii) vërtetimin e datës 11.6.2019, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Mbi bazën e këtyre vërtetimeve u rillogaritën të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të pasqyrohen në analizën financiare. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ngriti pretendime për shpenzimet e llogaritura për periudhën 1992 – 2003. Nga Komisioni u morën në konsideratë pjesërisht pretendimet e subjektit, duke bërë reduktimin e shpenzimeve për këtë periudhë në vlerën prej 111,888 lekësh, krahasuar me shpenzimet e llogaritura në analizën financiare të dërguar me rezultatet e hetimit.

24.49 Në vlerësim të gjithë të dhënave dhe provave të analizuara si më sipër, Komisioni kreu analizën financiare përfundimtare për periudhën 1992 – 2003, lidhur me pasuritë, të ardhurat

¹⁷ Deklaratat noteriale me nr. ***, dhe nr. ***, të datës 15.6.2019.

¹⁸ Neni 30, i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “...**Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.**”

dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, e cila reflektohet në tabelën e mëposhtme:

Analiza financiare për periudhën 1992 – 2003

Përshkrimi	Vlera në lekë
Të ardhurat, subjekti i rivlerësimit	4,099,659
Dhurime në <i>cash</i> , babai	1,500,000
Dhurime në <i>cash</i> , vjehri	1,000,000
Dhurime në <i>cash</i> dhe të ardhura, bashkëshortja	350,000
Dhurime, kunati	300,000
Total të ardhurat	7,249,659
Arredime, deklaruar	120,000
Shpenzime për jetesë, 1997 – 2003, deklaruar + ILDKPKI	1,793,424
Total shpenzime	1,913,424
Ndryshim mj. Monetare, deklaruar 1.1.1992 – 31.12.2003	0
Mjete monetare të disponueshme (1)	5,336,235
Pagese për blerje dhe krijim pasurie apartament+garazh	5,500,000
Total pasuri	5,500,000
Detyrime 31.12.2003	0
Pasuri neto (2)	5,500,000
Balanca e fondeve (1-2)	- 163,765

24.50 Si përfundim, Komisioni çmon se, pavarësisht se analiza financiare për periudhën 1992 – 2003 del me një balancë negative të fondeve në vlerë të vogël, nuk mund të vihet në dyshim aftësia financiare e subjektit për kryerjen e pagesave për prenotimin e këtyre pasurive dhe realizimin e shpenzimeve për përfundimin e apartamentit, kjo nisur edhe nga fakti se vlera totale e deklaruar e këtyre pasurive është e karakterit deklarativ dhe nuk disponohet ndonjë evidencë apo situacion punimesh lidhur me shpenzimet totale të kryera nga subjekti i rivlerësimit për përfundimin e apartamentit. Duhet pasur parasysh që analiza financiare para vitit 2003 nuk ka një bazë të saktë përlllogaritjeje, duke qenë se Komisioni nuk disponon të dhëna të sakta në lidhje me shpenzimet dhe koston e jetesës për person. Në këtë rast, balanca negative është -163,765 lekë për 10 vjet, pra, rreth 16,000 lekë në vit, vlerë e cila mund të jetë marzhi i gabimit në përlllogaritje dhe, për këtë arsye, nuk do të merret në konsideratë. Si rrjedhim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për kryerjen e pagesave për prenotimin dhe realizimin e shpenzimeve për pasuritë apartament + garazh.

25. Pasuritë, likuiditete: (i) **depozitë në “Raiffeisen Bank”** (fond investimi), me vlerë **5,500,000 lekë**; dhe (ii) **gjendje *cash*** në banesë, në shumën **1,200,000 lekë**, deklaruar 50 % në bashkëpronësi me bashkëshorten. Si burim krijimi të këtyre pasurive subjekti ka deklaruar kursimet nga të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes së tij ndër vite.

25.1 Deklarimi ndër vite i depozitës në “Raiffeisen Bank”, Fondi Prestigj: (1) Referuar DPV-së së vitit 2014, subjekti ka deklaruar se në datën 29.1.2014 ka depozituar në “Raiffeisen Bank” vlerën prej 4,000,000 lekësh (blerje kuotash). Pjesa tjetër, prej 2,400,000 lekësh, vazhdon të jetë *cash* në banesë. Lidhur me këtë vlerë të depozituar në “Raiffeisen Bank” subjekti ka deklaruar se buron nga kursimet vjetore të deklaruara periodikisht si *cash* në banesë dhe dy

llogaritë bankare: (i) llogaria 8,000 dollarë në “Intesa SanPaolo Bank”, tërhequr në janar të vitit 2014; dhe (ii) shuma 1,079,132 lekë tërhequr nga karta e pagës. (2) Referuar DPV-së së vitit 2016, subjekti ka deklaruar se në datën 21.10.2016 ka depozituar në “Raiffeisen Bank”, si fond investimi, vlerën 1,500,000 lekë.

25.2 Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këto pasuri

25.3 Referuar të dhënave të “Raiffeisen Bank”¹⁹, nga verifikimi i llogarisë në lekë nr. ***, të subjektit të rivlerësimit, rezulton se: (i) në datën 29.1.2014 është depozituar shuma prej 3,000,000 lekësh; dhe (ii) po në datën 29.1.2014, është transferuar shuma prej 1,000,000 lekësh nga llogaria nr. *** në ALL.

25.4 Në vijim, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka investuar në Fondin Prestigj në “Raiffeisen Bank”, shumat si më poshtë:

- i. në datën 29.1.2014 është investuar shuma prej 4,000,000 lekësh;
- ii. në datën 25.10.2016 është investuar shuma prej 1,500,000 lekësh.

25.5 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje (shkresës së ardhur nga “Raiffeisen Bank”) Komisioni vëren se subjekti, në deklaratën “Vetting”, ka deklaruar saktë të dhënat për gjendjen e Fondit Prestigj, në momentin e deklarimit.

25.6 Lidhur me gjendjen e deklaruar në *cash*, shumën prej 1,200,000 lekësh, Komisioni vëren se nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI konstatohet se ai në vazhdimësi ka deklaruar shtesa/pakësime të gjendjes *cash*, të cilat, të paktën sipas vetëdeklarimit, justifikojnë krijimin e kësaj gjendjeje në *cash*, deklaruar në deklaratën “Vetting”.

25.7 Bazuar në deklaratat periodike vjetore të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI²⁰ rezulton se, ndër vite, ka deklaruar shtesa/pakësime të gjendjeve *cash*, të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Periudha e deklarimit	Deklaruar shtesa/pakësime në lekë	Gjendje fundviti/lekë
DPV-ja 2005	- shtesë 350,000	350,000
DPV-ja 2006	- pakësim 350,000 - shtesë 200,000	200,000
DPV-ja 2007	- pakësim 200,000 - shtesë 200,000	200,000
DPV-ja 2008	- shtesë 940,000	1,140,000
DPV-ja 2009	- shtesë 450,000	1,590,000
DPV-ja 2010	- shtesë 1,000,000	2,590,000
DPV-ja 2011	- shtesë 400,000	2,990,000
DPV-ja 2012	- shtesë 600,000	3,590,000
DPV-ja 2013	- shtesë 500,000	4,090,000
DPV-ja 2014	- shtesë 400,000	2,400,000

¹⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 23.4.2018.

²⁰ Në nenin 32, të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se, “...*Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.*”

	- pakësuar 2,090,000	
DPV-ja 2015	- shtesë 300,000	2,700,000
DPV-ja 2016	- pakësuar 1,500,000	1,200,000

25.8 Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën 2004 – 2016 (vite në të cilat është krijuar Fondi Prestigj dhe gjendja *cash*, të deklaruar si më sipër), lidhur me të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi balancë negative fondesh për disa vite.

25.9 Për këtë shkak, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, për vitet për të cilat nga analiza financiare kanë dalë me balancë negative të fondeve.

25.10 Në prapësimet e sjella, subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka depozituar prova të reja duke pretenduar të ardhura shtesë dhe reduktimin e disa shpenzimeve, të cilat Komisioni, pasi i vlerësoi me objektivitet, i mori pjesërisht në konsideratë dhe konkretisht, janë reflektuar në analizën e treguesve financiarë për vitet 2004 – 2016: (i) të ardhura shtesë për periudhën janar – maj të vitit 2008²¹; (ii) dhurimet e deklaruara; (iii) reduktim shpenzimesh për udhëtimet; (iv) reduktim i shpenzimeve jetike për vitin 2007; dhe (v) reduktim i shpenzimeve të transportit.

25.11 Në vlerësim të të gjithë të dhënave dhe provave të paraqitura nga subjekti, Komisioni kreu analizën financiare përfundimtare për periudhën 2004 – 2016, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe personave të lidhur me të, nga ku, vitet me balancë negative të fondeve janë si më poshtë:

- i. viti 2004, balanca negative e fondeve - 298,260 lekë;
- ii. viti 2005, balanca negative e fondeve - 459,614 lekë;
- iii. viti 2006, balanca negative e fondeve - 309,193 lekë;
- iv. viti 2009, balanca negative e fondeve - 173,326 lekë;
- v. vitit 2010, balanca negative e fondeve - 136,114 lekë;
- vi. viti 2015, balanca negative e fondeve - 6,747 lekë.

25.12 Komisioni vëren se, nga analiza financiare e kryer, pjesën më të madhe të balancës negative e zënë vitet 2004 – 2006, për të cilat, siç u evidentua edhe më sipër, subjekti ka deklaruar shtesa të gjendjeve *cash* në vlera të vogla, të cilat janë pakësuar të gjitha në vitin 2007, pra nuk ka ndikuar më tej në gjendjen *cash* ndër vite, e cila ka shërbyer për krijimin e depozitës në Fondin Prestigj dhe gjendjen *cash* të deklaruar në deklaratën “Vetting”. Gjithashtu, në deklaratimet periodike vjetore është konstatuar se në vitet 2004 dhe 2005 subjekti ka deklaruar blerjen e dy automjeteve, secili për vlerën 500,000 lekë, ndërkohë që, sipas kontratës ato janë blerë secili në shumën 200,000 lekë. Edhe pse subjekti ka deklaruar se pjesa tjetër e vlerës është shpenzuar për zhdoganimin e këtyre automjeteve, gjithsesi, vlera e tyre nuk shkon në vlerën 500,000 lekë/secili. Në analizën financiare të viteve përkatëse, vlerat e këtyre automjeteve është marrë përkatësisht në shumën prej 500,000 lekësh. E përmendëm këtë fakt, për të evidentuar faktin se këto pasaktësi apo pasaktësi të tjera në deklaratimet e bëra nga subjekti mund të kenë/kanë ndikuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe në rezultatet e saj ndër vite.

²¹ Referuar vërtetimit me nr. *** prot., datë 11.06.2019, lëshuar nga DBMF në Prokurorinë e Përgjithshme.

25.13 Edhe për pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike të bëra ndër vite në ILDKPKI, të pasqyruara në rezultatet e hetimit, Komisioni vlerësoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit janë bindëse dhe se ato nuk sjellin pasoja në këtë proces, pasi nuk cenojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë.

25.14 Për sa më sipër trupi gjykues çmon se, pas analizës financiare të përditësuar mungesa e likuiditeteve (balancat negative), të shtrira përgjatë viteve, nuk janë në masën që të cenojnë besimin e publikut. Ky përfundim arrihet pasi natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, krahasuar me aspektet konkrete të jetës reale. Për sa arsyetohet më sipër, trupi gjykues çmon se mungesa e këtij likuiditeti (balancë negative fondesh) nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

26. Automjeti i përdorur nga subjekti i rivlerësimit

26.1 Në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni (pyetësori i datës 21.5.2018) subjekti ka deklaruar se ai dhe bashkëshortja e tij kanë përdorur automjetin në pronësi të shtetasit A. L., të markës “Ford”, me targa AA ***, për raste të veçanta udhëtimi, kryesisht për lëvizje familjare.

26.2 Nga të dhënat e përfutuara nga faqja e *web-it* e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) rezultojnë se në dy vite subjekti i rivlerësimit është shënuar si “përdorues” në policat e sigurimit të këtij automjeti. Ndërsa, nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezulton se subjekti ka udhëtuar disa herë jashtë vendit me këtë automjet, ndërkohë që shtetasi A.L., nuk e ka përdorur këtë automjet për dalje jashtë shtetit. Për periudhën nga qershori 2017 – qershor 2018, ky automjet është përdorur nga personi i lidhur/bashkëshortja, pa aktpërdorimi.

26.3 Nisur nga të dhënat e mësipërme, Komisioni ngriti dyshime lidhur me pronësinë e këtij automjeti. Për këtë arsye, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për marrëdhënien e tij me shtetasit e sipërcituar, si dhe të depozitojë dokumentacion justifikues ku të konfirmohet nëse ai ka hetuar/proceduar çështje penale/civile me palë këtë shtetas.

26.4. Në prapësimet e tij të depozituara në Komision subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka sqaruar se ky automjet është në pronësi të shtetasit A.L., shok dhe mik i familjes së tij, fakt i njohur botërisht në komunitetin ku ai jeton. Në vijim, subjekti shpjegon se këtë automjet e ka përdorur disa herë, në vitet 2015 – 2016, për periudha të shkurtra kohore (disa ditore) për udhëtime të gjata, kryesisht për udhëtimet drejt Tropojës, vendlindjes së tij, kjo edhe prej terrenit që kishte ajo rrugë në pjesë të caktuara. Për shkak të itinerarit të këtyre udhëtimeve brenda një rruge i është dashur të kalojë për në Kosovë, duke dalë në pikën kufitare të Qafë-Morinës, Kukës dhe duke hyrë përsëri në pikën kufitare Morinë-Tropojë. I njëjti itinerar bëhej në kthim. Kjo shpjegon dhe faktin se pse në sistemin *TIMS* duket sikur janë kryer udhëtime të shumta, ndërkohë që në një rrugë të vetme kalonte katër herë në pikat kufitare. Subjekti deklaroi se ky automjet është përdorur vetëm për raste të veçanta dhe se nuk është përdorur vetëm nga ai apo bashkëshortja e tij, pasi në të njëjtën kohë, në cilësinë e drejtuesit, ai ka pasur në përdorim automjetin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe se gjithashtu, disa herë, ka përdorur makinën e babait të bashkëshortes së tij edhe për udhëtime jashtë shtetit. Si

përfundim, subjekti deklaroi se ky automjet është pasuri e disponuar dhe e poseduar nga z. A.L., në pronësi vetëm të tij.

26.5 Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision provat shkresore, dokumentet si më poshtë:

- i. deklaratë noteriale me nr. ***, datë 21.6.2019;
- ii. vërtetim me nr. *** prot., datë 14.6.2019, nga “BKT”-ja, Durrës;
- iii. vërtetim i datës 14.6.2019, nga “Banka Ndërkombëtare Tregtare”;
- iv. kopje të certifikatës së pronësisë dhe e lejes së qarkullimit të mjetit me targa AA ***;
- v. kopje e policës së sigurimit të këtij automjeti në shoqërinë “***”, që mban datën 25.7.2018;
- vi. fotokopje, certifikata e kontrollit fizik e datës 18.6.2014 dhe certifikata e kontrollit teknik nga “SGS”, me vlefshmëri deri në datën 25.7.2019.

26.6 Për sa më sipër, nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se deklaratimet e subjektit lidhur me pronësinë dhe me përdorimin e këtij automjeti duken bindëse. Rezultoi e provuar se shtetasi A.L., është pronari i dy automjeteve dhe ka pasur mundësi financiare për blerjen e tyre. Nuk disponohen të dhëna që shtetasi i sipërcituar, i cili i ka dhënë në përdorim këtë automjet, të jetë me rekorde kriminale, i përfshirë në krimin e organizuar, ose i dyshuar si i përfshirë në krimin të organizuar. Komisioni konstaton se nuk qëndrojnë dyshimet e ngritura paraprakisht me rezultatet e hetimit.

27. Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

27.1 Pasi hetoi dhe shqyrtoi të gjithë dokumentacionin në lidhje me dy pasuritë e subjektit, përkatësisht apartament dhe garazh, kursime ndër vite në shumën 5,500,000 lekë dhe gjendje *cash* në shumën 1,200,000 lekë, në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht me të ardhurat e veta, si dhe i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Ai nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

27.2 Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

27.3 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, mbështetur në faktin se deklaratimet e pasakta të konstatuara në deklaratimet ndër vite, nuk cenojnë detyrimin e tij kushtetues, për deklaratim të saktë në deklaratën “Vetting”, Komisioni çmon se pasaktësitë e konstatuara nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, si dhe nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësisë. Komisioni vlerëson gjithashtu se pamjaftueshmëria, që rezultoi nga analiza financiare nuk është e një madhësie të tillë, që të sjellë lindjen e dyshimeve për veprime që cenojnë figurën e prokurorit.

27.4 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

28. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse kishte pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

28.1 Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, (deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë 17.10.2018). Sipas këtij raporti rezulton se subjekti kishte plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk kishte informacione nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të dyshuar ose të përfshirë në krimin e organizuar, duke konstatuar kështu përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

28.2 Në deklaratën për kontrollin e figurës, dorëzuar më 26.1.2017, subjekti, megjithëse i ishte përgjigjur “jo” pyetjes “A keni dijeni se një nga anëtarët e familjes suaj është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar?”, ka dhënë sqarimin: “Sa më lart dua të sqaroj se jam informuar nga im vëlla, A.M., se gjatë qëndrimit të tij si emigrant në Itali 1995 – 2003, ka marrë dhe kryer një dënim prej 11 muajsh, në vitin 2001 për Favorizim seksual të thjeshtë (individual) në Savona Itali”.

28.3 Vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, për të hedhur dritë mbi rrethanat e këtij fakti, vuri në dispozicion të Komisionit:

- Vendimin nr. ***, datë 18.12.2002, të Gjykatës së Savonës (Itali), e cila e ka shpallur A. M., fajtor për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve (*porto abusivo e detenzione di armi*) dhe e ka dënuar atë me dy muaj paraburgim, si dhe 100 euro gjobë.

- Vendimi nr. ***, datë 18.12.2002, nga Gjykata e Savonës (Itali), e cila e ka shpallur A. M., fajtor për veprën penale (*Indulzione alla prostituzione nel territorio dell' altro stato in concorso*) “shtytje/nxitje në prostitucion në territorin e një shteti tjetër në bashkëpunim”. Gjykata e ka dënuar me 4 vjet dhe 8 muaj burgim, dhe i ka hequr të drejtën për të ushtruar funksione publike për një periudhë 5-vjeçare. (Ky vendim si edhe certifikata e gjendjes gjyqësore lëshuar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Italisë i është dërguar Ministrisë së Drejtësisë për përkthim ligjor dhe administruar në cilësinë e provës duke u bërë pjesë e dosjes së rivlerësimit).

28.4 Komisioni, duke marrë shkas nga deklarimi i subjektit të rivlerësimit dhe provat e dorëzuara nga përfaqësuesi i ONM-së, iu drejtua DSIK-së me shkresën nr. *** prot., datë 27.12.2018, për t’i kërkuar informacion të mëtejshëm dhe rishikimin e mundshëm të raportit të grupit të punës në lidhje me aktivitetin kriminal të vëllait të subjektit, shtetasit A.M.

28.5 DSIK-ja, në datën 7.1.2019, dërgon raportin e rishikuar me nr. *** prot., (deklasifikuar plotesisht me vendim të KDZH-së nr. ***, date 3.5.2019) duke na bëri me dije disa dënime të marra nga A.M., në Republikën e Italisë. Në raport shprehet “Shtetasi A.S.M., (vëllai i Artan Madanit) në cilësinë e personit të lidhur”, sipas përcaktimit të pikës 13, nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, rezulton me rekorde kriminale në shtetin fqinj italian për veprat penale, si më poshtë vijon :

- i. në vitin 2001 për veprën penale “armëmbajtje pa leje”(armë e ftohtë);
- ii. në periudhën 13.9.2001 – 30.5.2002, është dënuar në burgun e Savonës/Itali për veprën penale “shfrytëzim prostitucioni”;
- iii. në vitin 2002 është dënuar me 2 muaj burgim për veprën penale “armëmbajtje pa leje”;
- iv. në vitin 2006 është dënuar me 4 muaj burgim për veprën penale “shfrytëzim prostitucioni”;
- v. në qershor të vitit 2006 i është dhënë masa “ndalim i kryerjes së funksioneve publike për pesë vjet”, në vijim të vendimit të Gjykatës së Apelit të Xhenovës për veprën penale “shfrytëzim prostitucioni”;
- vi. në qershor të vitit 2007 është dënuar me 11 muaj e 12 ditë burgim për veprën penale “shtrëngim dhe shfrytëzim prostitucioni”.

28.6 Gjithashtu, Komisioni informohet se *ky shtetas njihet me identitet tjetër dhe gjeneralitete të ndryshme dhe ka pasur rekorde kriminale në vitin 2002 për veprat penale “emigracion i paligjshëm” dhe “falsifikim dokumentesh”.*

28.7 Nga certifikata e gjendjes gjyqësore lëshuar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Italisë, ka rezultuar si më poshtë:

- a. Vendim i datës 23.12.2002 i Gjykatës së Savonës, me një gjyqtar të vetëm ka marrë formë të prerë më 13.4.2003, për veprën “armëmbajtje” (armë e ftohtë), ndodhur më 17.11.1999, në Savona:
 - i. **dispozitivi:** arrestuar 2 muaj, gjobë 100 euro;
 - ii. **masa e sigurimit:** konfiskim për sa është sekuestruar;
 - iii. **përfitime:** pezullim me kusht i dënimit, sipas nenit 163 të Kodit Penal.
- b. Vendim i datës 7.6.2006 i Gjykatës së Apelit të Xhenovas ka marrë formë të prerë më 17.12.2006, “Lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Savonës të datës 18.12.2002, për veprën penale “*indulzione alla prostituzione nel territorio dell altro stato in concorso*” (shtytje/nxitje në prostitucion në territorin e një shteti tjetër, në bashkëpunim), vepër penale e kryer nga 1.6.1999 – më 13.9.2001, në Savona:
 - i. **dispozitivi:** burgim 4 vjet e 8 muaj, gjobë 800 euro;
 - ii. **dënim plotësues:** ndalim të funksioneve publike për 5 vjet;
 - iii. **masë sigurimi:** konfiskim për sa është sekuestruar.

Urdhrat e mëvonshëm të lëshuara gjatë ekzekutimit të dispozitës

- a. Në datën 19.7.2007, me dekret të prokurorit të Republikës, përfshirë Gjykatën e Savonës, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit:
 - i. **Pezullohet dënimi** – Dënimi i mbetur i burgimit.

- b. Në datën 24.10.2007, me dekret të Prokurorit të Republikës përfshirë Gjykatën e Savonës urdhërohet revokimi i dekretit për pezullimin e ekzekutimit të dënimit.
- c. Në datën 15.6.2017, me urdhrin e gjykatësit të hetimeve paraprake të Gjykatës së Savonës dënimi shpallet i shuar për shkak të kalimit të kohës:
 - i. **Dënimi i shuar:** Të gjithë dënimin me burgim, të gjithë dënimin e gjobës.

28.8 Gjithashtu, DSIK-ja në raport shprehet: “Deklarimi i subjektit të rivlerësimit për përfshirjen e vëllait në një vepër penale që nuk përfshihet në krimin e organizuar, e që daton në vitin 2001 dhe mosdeklarimi i përfshirjes dhe dënimit të tij në disa vepra penale që përfshihen në krimin e organizuar dhe datojnë deri në qershor të vitit 2007, ngre dyshime të arsyeshme se është përpjekje e qëllimshme e subjektit për t’i fshehur këto fakte”.

28.9 DSIK-ja arriti në përfundimin: “Subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit dhe lidhjes së evidentuar me “personin e lidhur” si të përfshirë në veprimtari të paligjshme, e bën subjektin një individ që mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale, vlerësim i mbështetur në pikën c, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016.

28.10 Si konkluzion, DSIK-ja ka ndryshuar konstatimin fillestar të dhënë duke konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani, me raportin nr. *** prot., datë 7.1.2019, (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 3.5.2019, të KDZH-së,)

28.11 Pavarësisht nga sa më sipër Komisioni bëri një hetim të thelle e te pavarur për sa i përket kontrollit të figurës duke vlerësuar me objektivitet dhe paanshmëri provat dhe rrethanat lidhur me këtë çështje. Komisioni nuk është i detyruar të ndjekë apo të kenë qëndrime e konkluzione të njëjta me DSIK-në në përfundim të këtij procesi, por është autorizuar nga Kushtetuta dhe ligji, të bëjë hetime të mëtejshme për të kryer një proces rivlerësimi të pavarur e të pandikuar nga konkluzionet e institucioneve ndihmëse.

28.12 Aneksi i Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016, të drejtën për realizimin e procesit të rivlerësimit për subjektet e parashikuara në nenin 179/b të Kushtetutës ia atribuon Komisionit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Ligji parashikon të drejtën dhe kompetencën e organeve të rivlerësimit për të kryer vetë verifikime, çka mund ta bëjnë kryesisht nëse krijojnë bindjen se hetimi i organeve ndihmëse nuk ka qenë i plotë dhe i saktë.

28.13 Nisur nga sa më sipër iu kërkua Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda informacion në lidhje me shtetasin A.M., me shkresën nr. *** prot., datë 9.1.2019. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me shkresën nr. *** prot, datë 14.1.2019, informoi se për këtë shtetas nuk ka rezultuar asnjë fakt apo e dhënë për implikimin e kryerjes së veprave penale që hetohen prej tyre në bazë të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

28.14 Gjithashtu, Komisioni bazuar në pikën 11, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, i kërkoi një mendim me shkrim vëzhguesit të ONM-së në vlerësim tërësor të provave dhe fakteve në lidhje me kriterin e vlerësimit të figurës.

28.15 Vëzhguesi i ONM-së dha mendimin e tij në lidhje me aktivitetin kriminal të shtetasit A.M., gjatë qëndrimit në Itali. Ai i është referuar dy vendimeve dhe përkatësisht dënimet penale: *për armëmbajtje pa leje dhe shtytje/nxitje në prostitucion në territorin e një shteti tjetër në bashkëpunim*, të cilat janë të vetmet dënime të shpallura kundër A.M., nga gjykatat italiane. Faktet dhe rrethanat e tjera që dalin nga dokumentet e dosjes dhe nga raportet e organeve

ndihmëse (në veçanti: në vitin 2007, dënimi me njëmbëdhjetë muaj dhe dymbëdhjetë ditë burgim për shtytje të prostitucionit) nuk i referohen dënimeve të tjera, por vetëm ekzekutimit të mbajtjes në paraburgim në kuadër të procedimit penal që ka çuar në vendimin nr. ***, të vitit 2002.

28.16 Gjithashtu, ai vëren se në dy vendimet e lartpërmendura, A.M., nuk është dënuar për veprën përfshirje në krimin e organizuar. Veprat penale, pavarësisht sjelljes së një natyre të rëndë dhe të pahijshme për të cilat është dënuar, nuk kategorizohen si “krim i organizuar” sipas ligjit italian. Objekti i veprave penale për të cilat A.M., është dënuar në Itali nuk i korrespondon ndonjë prej veprave të referuara nga pika 15, e nenit 3, e ligjit nr. 84/2016. Në bazë të vendimeve të sipërpërmendura nuk mund të konsiderohet se shtetasi A.M., është një “*person i përfshirë në krimin e organizuar*”, ka konkluduar vëzhguesi ndërkombëtar.

28.17 Me mbylljen e hetimit administrativ subjektit i është vënë në dispozicion i gjithë dokumentacioni i deklasifikuar në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës. Pasi u njoh me raportin e përditësuar dhe me dokumentacionin përkatës, dha shpjegimet e tij. Ai pretendoi se raporti mbi kontrollin e figurës i përgatitur dhe i përditësuar nga DSIK-ja është në interpretim të gabuar të vendimit të Gjykatës së Savonës (Itali), duke mos iu referuar asaj se çfarë është vendosur në dispozitivin e vendimit të gjykatës, fakt i cili përbën dhe gjë të gjykuar.

28.18 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se i vëllai A.M., nuk është i përfshirë në kryerje të veprave penale të krimin të organizuar dhe nuk ka përdorur kurrë një emër apo identitet tjetër. Ai ka pretenduar se në formularin e kontrollit të figurës ka deklaruar dënimin e vëllait, sipas shpjegimeve të tij, për rastin e burgimit, ndodhur në vitin 2001, në mungesë të pasjes së një vendimi konkret gjykate në dispozicion. Ai ka shtuar se me ndryshimin e masës së sigurimit gjatë hetimeve paraprake (liruar më datë 29.5.2002), menjëherë i vëllai është angazhuar në fushën e sipërmarrjes individuale referuar kjo dhe dokumentit të lëshuar nga Dhoma e Tregtisë, Industrisë dhe Artizanatit Riviera Ligure dhe kodit fiskal, duke punuar për rreth dy vjet në Itali, duke mos iu shmangur përgjegjësisë penale dhe më pas në vitin 2004 është kthyer në Shqipëri.

28.19 Lidhur me sa me sipër, trupi gjykues konstaton se pika 8, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, jep një përkufizim të konceptit “Krim i organizuar, trafikim dhe korrupsion”, duke referuar se cilat janë veprat penale që klasifikohen si të tilla, ndërsa pika 15 e së njëjtës dispozitë jep përkufizimin e individëve të cilët në kuptim të ligjit nr. 84/2016, pra në kuadër të procesit të rivlerësimit, do të konsiderohen si persona të përfshirë në krimin e organizuar. Pra, pika 15, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 përcakton rrethin e personave të cilët, në kuadër të procesit të rivlerësimit do të konsiderohen si persona të përfshirë në krimin e organizuar, duke referuar si të tillë personat që janë proceduar për veprat sipas pikës 1, neni 3, i ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (në vijim ligji nr. 10192/2009, i ndryshuar).

28.20 Në një analizë të plotë të rrethanave të faktit dhe legjislacionit në fuqi, Komisioni konstaton se vepra penale për të cilën është dënuar A.M., nga Gjykata e Savonës, Itali, nuk bën pjesë në grupin e veprave penale që hyjnë në krimin e organizuar dhe nuk klasifikohet si ajo e parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili bën fjalë për “Rekrutim, transportim, transferim, fshehje ose pritje e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo të formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit”. Pra, neni 110/a i Kodit Penal nuk përfshin shtytjen/nxitjen në prostitucion pa rrethana të agravuara, siç është rasti i shtetasit A.M.

28.21 Komisioni vëren se, në bazë të pikës 2, të nenit DH, të Aneksit Kushtetues thuhet “*Subjektet e rivlerësimit, plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën deklarimit, sipas ligjit*” subjekti i rivlerësimit ka bërë të ditur dënimin e vëllait të tij A.M., edhe pse shtrihej 10 vjet pas në kohë nga afati ligjor që kërkohet në plotësimin e formularit për kontaktet e papërshtatshme. Nga analiza e provave dhe fakteve rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë një deklaram të plotë dhe të sinqertë, duke tejkaluar edhe parashikimet ligjore. Ai ka dhënë detaje të cilat e kane çuar Komisionin në një hetim të plotë dhe të thelluar, hetim i cili arriti të zbardhë situatën dhe të zbehë çdo dyshim të ngritur në fillim të fazës hetimore.

Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës

29. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha provave, fakteve dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës.

29.1 Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

29.2 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

30. Komisioni, në vlerësimin e aftësive profesionale është bazuar në shqyrtimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (3) raportit të Grupit të Punës në Prokurorisë së Përgjithshme; si dhe (4) denoncimeve të depozituara në Komision.

30.1 Në raportin e Grupit të Punës janë analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Nga dokumentacioni i administruar gjatë Hetimit Administrativ rezulton se:

Prokurori Artan Madani: (1) për periudhën gusht 1992 deri në shtator 1993 ka ushtruar funksionin e hetuesit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë; (2) për periudhën shtator 1993 deri shtator 1997 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë; (3) për periudhën tetor 1997 deri dhjetor 2000 ka ushtruar funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; (4) për periudhën dhjetor 2000 deri qershor 2001 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; (5) për periudhën qershor 2001 deri më mars 2008 ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; (6) për periudhën prill 2008 deri më prill 2012 ka ushtruar funksionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; (7) për periudhën prill 2012 deri më shkurt 2015 ka

ushtruar funksionin e zv/drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; (8) për periudhën shkurt 2015 dhe aktualisht ushtron detyrën e drejtuesit të prokurorisë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

30.2 Nga shqyrtimi i raportit të Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurori Artan Madani, nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Nga vlerësimet e punës për vitet 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se prokurori Artan Madani është vlerësuar në mënyrë përfundimtare “shumë mirë”, (i) për aftësitë profesionale të treguara prej tij; (ii) për aftësitë personale e etike si dhe respektimin e disiplinës në punë dhe; (iii) për aftësitë personale dhe të qëndrimit shoqëror.

30.3 Nga vlerësimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitura prej tij si dhe në 5 dosjet/praktikat e vëzhguara, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit, prokurori Artan Madani ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai identifikon normën ligjore të zbatueshme, jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore apo me praktikën gjyqësore. Ai shfaq aftësi të për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime në përputhje me kërkesat ligjore dhe nevojat e hetimit.

30.4 Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Aktet e përpiluara prej tij, konceptohen të ndara në pjesë, të qarta. Aktet kanë strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Konstatohet se në ushtrimin e funksionit të drejtuesit të prokurorisë, prokurori Artan Madani, në rastet kur disponon me vendime shfuqizimi, arsyeton vendimin e tij mbështetur në dispozita ligjore, analizon në tërësi rrethanat e faktit, të dhënat e grumbulluara gjatë hetimit dhe mangësitë e hetimit.

30.5 Nga aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet/aktet e shortuara, ka rezultuar se ai ka ushtruar funksionin, mbështetur në nenin 24 të Kodit të Procedurës Penale dhe akteve nënligjore, që e përcaktojnë atë si prokuror më i lartë me fuqinë e ndryshimit dhe shfuqizimit të vendimeve të marra nga prokurori më i ulët, si dhe mbështetur në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, etj. Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, prokurori Artan Madani, për shkak të detyrës që ka kryer, analiza e të dhënave të saj bëhet në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe KEDNJ-së, akte këto të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ai ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Nga analiza e çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se qëndrimi i tij është shprehur brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Konstatohet se aktet janë marrë brenda afateve ligjore.

30.6 Në kuadër të veprimtarisë organizative, subjekti i rivlerësimit, prokurori Artan Madani, ka marrë vendime shfuqizimi në respektim të nenit 24 të Kodit të Procedurës Penale dhe akteve nënligjore, që e përcaktojnë atë si prokuror më i lartë me fuqinë e ndryshimit ose shfuqizimit

të vendimeve të marra nga prokurori më i ulët si dhe mbështetur në ligjin nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

30.7 Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet/praktikat e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

30.8 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Artan Madani, dhe nga dosjet/praktikat e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

30.9 Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Artan Madani, në asnjë prej dosjeve të vëzhguara. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

30.10 Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, prokurori Artan Madani të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

Denoncimet e publikut të depozituara në Komision

31. Mbi denoncimet e ardhura në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani

31.1 Denoncimi nr. *** prot., datë 15.3.2018. Denoncues: subjekti “****” sh.p.k.

Objekti i denoncimit: Ankim për zvarritjen e rihetimit të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Sipas denoncuesit rihetimi i procedimit penal nr. ***, të vitit 2016, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë është vendosur më 23.11.2017 nga Gjykata e Apelit Durrës. Ky procedim rihetohet nga prokurori F.E., dhe drejtues i prokurorisë është subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani.

Në shpjegimet e tij lidhur me këtë denoncim subjekti ka sqaruar se, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë ka evidentuar se rasti është zvarritur nga prokurori i çështjes dhe ky fakt është dokumentuar në formularin që ka shoqëruar dosjen, të cilin e ka depozituar si provë në Komision.

Vërehet se pas ankimit, Gjykata e Apelit Durrës e ka kthyer çështjen për hetime dhe në datën 10.1.2018 është vendosur regjistrimi i procedimit penal duke u ngarkuar prokuror tjetër për ndjekjen e çështjes dhe se çështja është në hetim.

Rezulton se në kohën që po rihetohet ky procedim ka qenë në fuqi ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Neni 6 i këtij ligji i jep pavarësi prokurorit të çështjes në marrjen e vendimeve dhe mënyrën e hetimit.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim

nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani.

31.2 Denoncimi nr. *** prot., datë 28.5.2018. Denoncues: shtetasja N.U.

Objekti i denoncimit: Vendimmarrje e padrejtë dhe moskryerje të hetimeve.

Sipas denoncueses, subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, nuk ka kryer hetime dhe merr vendime të padrejta dhe se ky person i ka shkaktuar asaj dëme psikologjike dhe shëndetësore. Por, vërehet se denoncuesja nuk jep fakte apo rrethana konkrete në lidhje me subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani.

Në shpjegimet e tij, lidhur me këtë denoncim, subjekti ka deklaruar se nuk ka pasur asnjë kontakt me këtë shtetase (për të cilën sqaron se është banore e qytetit të Durrësit) dhe se nuk ka hetuar ndonjë çështje konkrete që të ketë lidhje ky person. Subjekti ka depozituar si provë shkresën me nr. *** prot., datë 13.6.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani.

31.3 Denoncimi nr. *** prot., datë 13.7.2018. Denoncues: shtetasi J.M.

Objekti i denoncimit: Mosmarrje masash për të shmangur shkeljet ligjore që bëjnë prokurorët e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Sipas denoncuesit janë marrë dy vendime mosfillimi për të njëjtin kallëzim të bërë prej tij ndaj punonjësve të disa institucioneve shtetërore në vitin 2015 dhe në vitin 2018. Në vitin 2015 prokurori D.B., ka vendosur mosfillimin e kallëzimit nr. ***, të vitit 2015, pasi fakti nuk parashikohet si vepër penale. Denoncuesi J.M., nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatë të këtij vendimi.

Denoncuesi J.M., i është drejtuar në atë kohë Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurori të Përgjithshme, të cilët, me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2015, e kanë informuar se përfundimet e prokurorit të çështjes rezultojnë, të bazuara si për natyrën juridiko – civile të mosmarrëveshjeve të tij me shtetasin e kallëzuar N.T., ashtu edhe për mungesën e elementëve të veprës penale.

Në muajin mars të vitit 2018, z. J.M., bën të njëjtin kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Prokurori i çështjes, z. D.B., ka vendosur mosfillimin e procedimit penal këtë çështje dhe denoncuesi nuk e ka ankimuar në gjykatë këtë vendimmarrje të prokurorit, e cila është e pavarur nga vullneti i drejtuesit të prokurorisë.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit, z. Artan Madani.

31.4 Denoncimi nr. *** prot., datë 20.11.2018. Denoncues: shtetasi Gj.M.

Objekti i denoncimit: Vendim i padrejtë.

Sipas denoncuesit ai është dhunuar nga nënprefekti i Mirditës më 23.1.2009, dhe i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë ku drejtuesi i saj, z. Artan Madani, ka urdhëruar fillimin e hetimeve. Sipas denoncuesit, pas katër muajve prokurori i çështjes M.B., pushoi hetimet me arsyetimin se nuk ka prova.

Denoncuesi vuri në dispozicion dokumentin, shkresën me nr. *** prot., datë 5.6.2009, të firmosur nga drejtuesi i prokurorisë, z. Artan Madani, me qëllim njoftimin e vendimit nr. *** të datës 28.5.2009, “Për pushimin e ndjekjes penale për shtetasin Gj.P.”, të prokurorit të çështjes, M.B.

Nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme është shfuqizuar vendimi i pushimit dhe më tej kjo çështje është dërguar për rihetim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

Subjekti ka deklaruar se në periudhën nga data 28.6.2010 deri më 14.9.2011 ai ka ushtruar funksionin e tij në Prokurorinë e Rrethit Vlorë. Me tej, ka shpjeguar se kjo çështje ishte dërguar për gjykim dhe ai është vënë në dijeni vetëm në momentin e diskutimit të konkluzioneve përfundimtare të prokurorit që përfaqësonte çështjen (kjo bazuar në urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm), ku në përfundim, nga prokuroria është kërkuar deklarimi fajtor i të pandehurit Gj.P., dhe dënimi i tij me gjobë në vlerën 500,000 lekë. Gjykata e Shkallës së Parë Lezhë, me vendimin nr. ***, datë 17.1.2012 vendosi deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Gj.P. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim brenda afatit ligjor (në këtë kohë ai ka qenë drejtues i prokurorisë), por Gjykata e Apelit Shkodër vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Rezulton se edhe kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është bërë recurs, por Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 4.3.2015, ka vendosur mospranimin e recursit.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi vërehet se, kundërshtohen aspekte që kanë të bëjnë me vendimmarrjen e prokurorit të çështjes dhe se denoncuesi nuk paraqiti asnjë rrethanë apo provë konkrete që të lidhte subjektin të rivlerësimit, në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, me veprime korruptive, shkelje të etikës së gjyqtarit apo shkelje procedurale të kryera gjatë gjyqimit.

31.5 Denoncimi nr. *** prot., datë 5.2.2019. Denoncues: shtetasi A.L.

Objekti i denoncimit: Vendim i padrejtë.

Sipas denoncuesit, shtetasi F.M., me të cilin ka pasur kallëzime të ndërsjella në lidhje me pronësinë e dy vilave që prej rreth 8 vjetësh, është djali i dajës së Artan Madanit dhe se Prokuroria e Kavajës ka favorizuar z. F.M.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur, në datë 25.3.2019 është thërritur për të dëshmuar pranë Komisionit shtetasi A.L., i cili u pyet nga Komisioni dhe dha dëshminë e tij, e cila është pjesë e dosjes së rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka deklaruar se ka lidhje farefisnore me shtetasin F.M., por në asnjë rast nuk e ka favorizuar atë. *“Thjesht rrethanat e lidhjes time farefisnore me personin F.M., nuk mundet të justifikojnë problematikat e pretenduara nga denoncuesi. Nuk kam qenë në dijeni të asnjë konflikti apo rrethane që shtetasit F.M., dhe A.L., kanë midis tyre. Për më tepër sqaroj se unë ushtroj detyrën e prokurorit në Kavajë që prej datës 24.9.2014 dhe gjatë gjithë kësaj periudhe në Prokurorinë e Kavajës nuk ka pasur asnjë kallëzim penal apo në formë ankese nga shtetasi A.L.”* - ka sqaruar subjekti i rivlerësimit.

Nga shqyrtimi i këtij denoncimi dhe nga vlerësimi i dëshmisë së marrë vërehet se denoncuesi nuk paraqiti asnjë rrethanë apo provë konkrete që të lidhte subjektin të rivlerësimit me veprime

korruptive, shkelje të etikës së gjyqtarit apo shkelje procedurale të kryera gjatë procedurave hetimore.

Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional

Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe pesë denoncimeve të depozituara ndaj këtij subjekti në Komision, si më sipër, trupi gjykues nuk gjeti asnjë indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

Mbështetur në raportin e Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe shqyrtimin e pesë denoncimeve, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

Nga sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Artan Madani, ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit gurmës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Madani, me funksion prokuror/drejtuës në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

2. Ky vendim i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

4. Ankimi depozitohet në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 1.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA

Kryesuese

(Kundër)

Genta TAFA (BUNGO)

Anëtare

Pamela QIRKO

Relatore

Gledis Hajdini

Sekretare gjyqësore